



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë më 12.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II” *(Komision për dhënie mendimi)*.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri” *(Komision për dhënie mendimi)*.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Dorina Çinari - Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Enea Karakaçi - drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Agim Bregasi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Ardian Islami - përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Anisa Pina - specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Alfred Bundo - përfaqësues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Genta Prodani – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumin për ta vazhduar mbledhjen me rendin e ditës e kemi. Sot do të diskutojmë dy çështje, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator për këtë projektligj është zoti Adnor Shameti.

Pikë e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”. Edhe për këtë marrëveshje komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator është zoti Edmond Leka.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre zonja Dorina Çinari, zëvendësministre, si dhe stafi që e shoqëron atë. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Dajana Sorensen, zëvendësministre.

Ju lutem, ju jeni edhe për marrëveshjen e parë, prandaj mund të vini dhe të zini vend!

Gjithashtu, zonja Genta Prodani, specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

A ka përfaqësues nga Bashkia e Tiranës?

Nuk ka.

Nga Bashkia e Tiranës kishte konfirmuar pjesëmarrjen e tij zoti Arbian Mazniku, nënkryetar i bashkisë, por siç duket nuk është paraqitur sot.

Gjithsesi, pa u vonuar vazhdojmë me marrëveshjen. Zonja Zëvendësministre, ju lutem, një prezantim të shkurtër të marrëveshjes.

Fjala për ju.

Dorina Çinari – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Marrëveshja që kemi sjellë sot para jush është marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW-së, e cila synon financimin me një fond grant prej 2 milionë e 32 mijë euro për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza e dytë e projektit. Sigurimi i këtij financimi grant në vlerën 2 milionë e 32 mijë euro do t'i bashkohet financimit të dakordësuar me qeverinë gjermane paraprakisht në vlerën e 4,5 milionë eurosh, që ka qenë faza e parë, për të cilat tashmë i janë ratifikuar marrëveshjes qeveritare, përkatësisht me ligjin nr. 69 të vitit 2016.

Financimi synon zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në rehabilitimin e godinave të konvikteve të Universitetit të Tiranës, ku parashikohet rehabilitimi i 5 godinave në gjendjen më të vështirë fizike. Aktualisht është në fazën e zbatimit marrëveshja përkatëse e financimit për fazën e parë të lidhura me KfW-në, për të cilat Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vijuar ngritjen e grupeve të punës, komitetin drejtues dhe të njesisë së zbatimit të projektit.

Objektivi i programit që mbulon kjo marrëveshje është që financimi i marrëveshjes i bashkohet qëllimit të programit për aplikimin e masave të eficiencës së energjisë në godinat e konvikteve me objektiva si më poshtë:

Auditimi energjetik i ndërtesave për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë. Kjo është faza e parë e projektit.

Identifikimi i nevojave për rinovimin e ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre, me qëllim zgjatjen e ciklit të jetës së ndërtesave.

Identifikimi i masave të ndryshme të eficiencës së energjisë që mund të aplikohen dhe llogaritja...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave i kemi të pranishëm...

Bashkim Fino – Ju jeni njerëzit që do të ndihmoni për asistencat...

Ulsi Manja – Në fillim do të na e shpjegojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Energjetikës dhe më pas përfaqësuesit e Ministrisë së Financave...

Bashkim Fino – Në qoftë se ka gjëra teknike për ministrinë e linjës së Damianit mund të flasim...

Ulsi Manja – Zoti Fino, mund të flisni me mikrofon, duke e marrë fjalën për procedurë.

Bashkim Fino – Kur ka një marrëveshje ose një kredi, duhet të flasin ata që e kanë përgatitur, kush e merr, kush e përfiton dhe kush e ekzekuton, por në fillim duhet të flasin përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, pse e kanë marrë dhe kush e ka marrë. Bashkia e Tiranës e përfiton. Më pas ta marrë fjalën ministria e linjës, sepse në fund të fundit ajo punën do të bëjë, të paktën kështu e kuptoj unë. Kjo e shpjegon shumë mirë të gjithë ecurinë. Nuk kam vërejtje.

Ulsi Manja- Mund të vazhdoni, zonja Çinari, dhe pastaj bëjmë përmbylljen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zëvendësministrja e Financave këtu është, kështu që mund ta përmbyllë, pas fjalës së zonjës Çinari.

Dorina Çinari - Duhet të ishte Bashkia e Tiranës, sepse ata duhet ta mbrojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem, zonja Çinari, vazhdoni!

Dorina Çinari - Programi, gjithashtu, synon reduktimin e konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave duke synuar që treguesi i performancës së energjisë të arrijë në 75 kw/orë për metër katrorë në vit, si dhe llogaritjen e dyoksidit të karbonit si rezultat i masave dhe vendosjes së kushteve të performancës së lartë sipas standardeve të BE-së.

Programi synon rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, i cili do të përfshijë rehabilitimin e 5 godinave sipas përcaktimeve në marrëveshjet financiare që tashmë janë dakordësuar, përveç rehabilitimit energjetik të ndërtesave.

Programi do të mbulojë në mënyrë të konsiderueshme masat themelore të komfortit, sipas kushteve të vendosura nga ligji nr. 116/2016, siç janë: rinovimi i instalimeve sanitare, rinovimi i pajisjeve elektrike, instalimi i paneleve diellore, sistemi i ngrohjes, ftohjes, ventilimit, prodhimi i ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë, dhoma të përbashkëta studimi në mënyrë që të përmirësohet në përgjithësi cilësia e jetës së studentëve.

Vlera e projektit në total do të arrijë 6,5 milionë euro.

Ulsi Manja -Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesja e Ministrisë së Financave.

Dajana Sorensen- Sa i përket projektit në vetvete, nuk kemi asnjë detaj tjetër për të shtuar.

Sa i përket kostos financiare, bëhet fjalë për grant të alokuar nga qeveria gjermane. Kostoja specifike e këtij projekti në buxhetin e shtetit nëpërmjet TVSH-së është në vlerën 1,3 milionë euro.

Ulsi Manja – Po, relatori.

Adnor Shameti - Faleminderit!

Sikurse e parashtroan edhe zëvendësministret që folën pak më parë përpara Komisionit të Ligjeve, është paraqitur një projektligj, për ratifikimin e fazës së dytë të marrëveshjes së plotë grantit midis qeverisë së Gjermanisë dhe qeverisë së Shqipërisë. Në këto kushte, bëhet fjalë për rikonstrukcionin e pesë objekteve në Qytetin Studenti. Në tërësi projektligji është në përputhje me të gjithë legjislacionin.

Ftoj anëtarët e komisionit ta miratojnë variantin që është paraqitur.

Ulsi Manja – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Bashkim Fino- Unë kam një pyetje dhe një sugjerim.

Në këtë projektligj thuhet se kostoja lokale e projektit do të përballohet nga buxheti i shtetit, mua më vjen mirë, por ju keni sjellë si Ministri e Financave shumë herë grante dhe kredi ku koston lokale e kanë paguar organet e pushtetit vendor. Unë mendoj se do të ishte mirë që, kur marrim kredi ose grante, të jetë e sanksionuar që kostot lokale, kur i merr përsipër shteti, i paguan shteti, pse t'i paguajë pushteti lokal. Në rastin konkret më bëhet qejfi që i paguan buxheti i shtetit dhe nuk e paguan Bashkia e Tiranës, por në disa raste gjithmonë kemi pasur qëndrime të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zoti Çuçi, për korrektësi, po ju them se në pikën 8 thuhet: “Buxheti i shtetit, i cili do të mbulojë TVSH-në dhe koston lokale të buxhetit nga buxheti i shtetit, të parashikuar në shumën 1,3 milionë euro”. Kjo do të thotë se do ta paguajë buxheti i shtetit jo Bashkia e Tiranës. Unë këtë dua të them që kostot lokale mirë është të përballohen nga buxheti i shtetit, ose të mos ketë dy standarde, pra jo kur nuk kemi interes të themi ta paguajë bashkia x dhe ne po japim kredinë ose grantin dhe, kur kemi interes, të themi ta paguajmë ne, së pari.

Së dyti, është ajo që kam ngritur prej kohësh, grantet nuk mund të kalojnë në parlamentin shqiptar. E kam thënë prej kohësh, granti është falas. Ne po bëhemi pis, zoti kryetar, po ngremë dorën 140 veta për një grant që do një qeveri, të të thotë 2 milionë euro t'i jap grant! S'ka lidhje fare! Parlamenti është për politika të mëdha, është për kreditë, për të cilat mban përgjegjësi politike, për fëmijët që vijnë më pas, të paguajë interesa e të tjera me radhë, por jo të paguajë garantët. Ne vazhdojmë diskutojmë për grantet dhe kalojmë 1-2 milionë euro që nuk janë asgjë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zonja Hysi ka një pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, të dyjave zonjave zëvendësministre!

Në fakt, ndjehem shumë mirë që më së fundi korpusi i Universitetit të Tiranës i nënshtrohet rehabilitimit të 5 godinave. Pyetja ime konsiston në atë çfarë keni shkruar në relacion. Në faqen 2 të tij keni shkruar që aktualisht po procedohet me marrëveshjen përkatëse të financimit, si dhe në një marrëveshje tjetër që do t'i nënshtrohet procedurës.

Marrëveshja tjetër që përmendni në paragrafin e dytë të relacionit ka të bëjë me rikonstrukcionin dhe rehabilitimin e këtyre 5 godinave, apo është në plan edhe rikonstrukcioni i godinave të tjera të konvikteve të Universitetit të Tiranës?

Pyetja e dytë: kemi pasur një grant për konviktet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. A është përfunduar si projekt?

Ardjan Islami – Për sa i takon pyetjes së parë të zonjës deputete, po, është e vërtetë! Ministria e Financave së bashku me KfW-në, qeveria gjermane me atë shqiptare, janë në procedura negocimi për një fond tjetër shtesë granti prej 2,9 milionë eurosh, i cili do të bëjë të mundur shtimin në rehabilitim edhe të dy konvikteve të tjera. Paraprakisht jemi në procedura negocimi, kështu që për detaje të mëtejshme ndoshta është mirë të flasim në një moment tjetër.

Për sa i takon projektit në lidhje me konviktet e Universitetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, projekti është në implementim. Tashmë janë rehabilituar dy godina dhe ndërkohë po vazhdon projekti i zbatimit me dy godinat e tjera.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Hyseni ka pyetje.

Alket Hyseni – Nuk mund të rrija pa folur duke qenë se ky projekt është iniciuar në periudhën kur unë kam pasur kënaqësinë të jem kryetar i këshillit mbikëqyrës të ndërmarrjes, tek e cila do të shkojnë këto financime, pra, ish-Qyteti Studenti, i quajtur dikur ose Qendra Rezidenciale Studentore nr. 1. Është një projekt shumë i rëndësishëm, bëhet fjalë për një qytet, i cili ka histori me vlera të paçmuara në periudhën e ndërrimit të sistemeve në Shqipëri, por edhe në përgjithësi në fushën akademike me nevoja shumë të mëdha, në një gjendje të mjerueshme, kështu që ftoj kolegët që ta mbështesin fuqimisht këtë.

Do të dëshiroja që të ishte prezent këtu së paku drejtoresha e kësaj ndërmarrjeje, e cila ka bërë një punë shumë të madhe për këtë projekt së bashku me Bashkinë e Tiranës, dikur me Ministrinë e Ekonomisë, tashmë është në pronësi të Bashkisë së Tiranës.

Nga ana tjetër, gjej rastin të komplimentoj Ministrinë e Financave që ka siguruar edhe pjesën e grantit.

Duke u bashkuar edhe me shqetësimin e zotit Fino, do t'ju ftoja që këtë politikë ta kishit kudo, sepse të njëjtin projekt keni siguruar për gjimnazin e Bashkisë së Sarandës, ndërkohë që barra e pagesës së grantit i ra një bashkie të vogël, pavarësisht se pjesa e saj ishte në vlerën e 30 milionë lekëve, por do të ishte normale që edhe këtë pjesë ta mbulonte Ministria e Financave.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Nuk besoj se ka pyetje të tjera dhe as diskutime.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”

Kush është dakord në parim?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi këtë projekt marrëveshje.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet në tërësi projekt marrëveshja “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”.

Raporti, së bashku me raportin e Komisionit të Ligjeve, së bashku edhe me sugjerimet e kolegëve do t’i përcillen komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare.

Faleminderit, përfaqësuesve të Ministrisë së Energjetikës dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë më 12.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri” (*Komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Genta Prodani – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri””.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Leka.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë sot kemi të pranishme zëvendësministren, zonjën Sorensen dhe zonjën Brikena Jazxhi, që është specialiste.

Urdhëroni, zonja Sorensen!

Dajna Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Bëhet fjalë për marrëveshjen e zbatimit të një projekti të qeverisë gjermane, projekt këshillimi për migracionin. Kjo është një pjesë e një programi global që ka qeveria gjermane dhe ministria federale gjermane për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim. BMZ-ja ka përzgjedhur GIZ-in si partnerin për zbatimin e këtij projekti në vetvete. Është lufta kundër migracionit të parregullt duke ofruar informacion dhe këshillim për të gjithë ato palë të interesuara mbi migracionin e rregullt, punësimin në Gjermani, ashti sikurse edhe për të informuar mbi ofertën e arsimit dhe të formimit profesional dhe perspektivat e tregut të punës qoftë në Shqipëri, ashtu edhe në Gjermani.

Projekti do të zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe GIZ-in. Në vetvete bëhet fjalë për një grant të masën 1,5 milionë euro, për sa i përket kontributit gjerman. Disa nga produktet specifike konkrete të këtij projekti kanë të bëjnë, në radhë të parë, me elementin e këshillimit.

E dyta, botimin e materialeve informuese mbi rregullat dhe aksesin në tregun e punës për shtetasit shqiptarë apo të vendeve të treta në tregun e punës të Gjermanisë, ngritjen e kapaciteteve të sporteve të migracionit, që ndodhen pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, krijimin e një faqeje interneti me gjithë informacionin e nevojshëm mbi këtë grup të synuar.

Gjithashtu, në të ardhmen parashikohet edhe hartimi i një strategjie për marrëdhëniet me publikun, pikërisht për sportelet e migracionit dhe hartimi i një dokumenti strategjik për Ministrinë e Financave për sa i përket politikëbërjes mbi migracionin e punësimit të orientuar ndaj zhvillimit.

Hartimi i një manuali specifik për sportelet e migracionit dhe dhënia e kontributit financiar dhe mbështetjes qoftë kjo në konferenca apo takime pune.

Parashikohet që çdo vit rreth 2000 veta do të jenë përfitues të drejtpërdrejtë nëpërmjet shërbimeve të këshillimit për migracion dhe zhvillim nëpërmjet qendrave të këshillimit.

Aktualisht projekti ekziston fizikisht pranë zyrave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Tiranë.

Marrëveshja do të jetë në fuqi deri në nëntor të vitit 2020. Për sa i përket implikimeve financiare në buxhetin e shtetit bëhet fjalë për një kosto lokale prej 90 mijë eurosh për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Leka!

Edmond Leka - Faleminderit!

Informacioni nga zëvendësministrja ishte shterues. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”, synon të fokusohet në këshillimin për migracionin, këshillimin për politikën e migracionit, për kthimin e emigrantëve të orientuar nga zhvillimi, bashkëpunimi me diasporën dhe ide biznesin për zhvillimin.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t’i ofrojë GIZ-it deri në 1,5 milionë euro. Ky është kontributi gjerman, i cili është i ndarë në 4 komponentë, si më poshtë, sigurimi i ekspertëve, furnizimi me materiale dhe pajisje, kostot operative dhe administrative dhe kontribute të tjera.

Pala shqiptare do të fokusohet në këta nënkomponentë:

Sigurimi i ekspertëve që do të kontraktohen nga GIZ-i dhe përfshirja e personave, stafi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kostot ku përfshihen shpenzimet që do të bëhen, kryesisht në vendin tonë, sigurimi i mjediseve, ndërtesave dhe ambienteve në punë, dhe kontribute të tjera ku parashikohet që Ministria e Financave, në bashkëpunim me njësitë e tjera kombëtare e rajonale,

të mbështesë në zbatim të projektit. Nga aspekti ligjor dhe aspekti procedural, kjo është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, ndaj ftoj kolegët ta miratojnë këtë projekt marrëveshje.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

Ka pyetje nga kolegët? Zoti Çuçi ka një pyetje.

Bledar Çuçi – Së pari po bëj një pyetje për zonjën zëvendësministre, e pastaj mund të kem një koment apo një diskutim.

Ju thatë se ka dy blloqe komponentësh. Komponenti i parë lidhet me asistencë ose oferta që do t'u jepet shqiptarëve për Gjermaninë. Komponenti i dytë ka të bëjë me atë që ju thatë, të cilën nuk e kuptova mirë, ndaj pres një shpjegim pak më të gjerë, ka të bëjë me një lloj fushate ndërgjegjësuese në lidhje me arsimin profesional në Shqipëri. Apo jo? Se nuk u sqaruam mirë.

Çfarë vendi zë kjo e dyta në gjithë pjesën e marrëveshjes dhe çfarë kuptohet? Një çikë më konkretisht në lidhje me këtë pjesë.

Ulsi Manja – Po, zonja Sorensen!

Dajna Sorensen – Ju e keni kuptuar qartë. Për sa i përket informacionit mbi Gjermaninë, nëpërmjet zyra të projektit sigurohet informacion për ata që janë të interesuar për t'u punësuar në Gjermani, në lidhje me procedurat e emigrimit për arsye punësimi. Ky do të jetë një nga elementët e projektit, për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me këtë temë.

Për sa i përket arsimit dhe formimit profesional, për shumë të rinj arsimit dhe formimi profesional është një rrugë e sigurt në tregun e punës. Një pjesë e madhe e atyre individëve që potencialisht kanë qenë target për emigrim të paligjshëm drejt Gjermanisë, po të ishin hulumtuar pak më hollësisht në lidhje me mundësitë që ofrohen në tregun lokal, qoftë kjo nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional, ndoshta nuk do ta kishin ndërmarrë atë hap.

E njëjta gjë edhe për ata që janë emigrantë të kthyer nga Gjermania, por të cilët, nëpërmjet këtij projektin do të asistohen për t'u integruar në tregun e punës. Domosdoshmërisht, ata do të orientohen drejt shkollave profesionale në ato raste, por në shumicën e rasteve bëhet fjalë për qendrat e formimit profesional që, nëpërmjet kurseve afatshkurtra, do të jenë në gjendje të hyjnë në tregun e punës.

Ulsi Manja – Po, zoti Çuçi!

Bledar Çuçi – Faleminderit për shpjegimin, por pikërisht këtë doja të dija: raportin që zë kjo e dyta në projektin e madh. Domethënë, nga projekti prej 1, 5 milionësh, që do të japë qeveria

gjermane, plus 100 mijë euro që jep qeveria shqiptare, sa para do të shkojnë për këtë të dytën, pra për t'i nxitur shqiptarët të përqafojnë arsimin profesional, për ta kuptuar arsimin profesional si një mundësi e artë për ngritjen e një jete të qëndrueshme brenda në Shqipëri. Dua të di raportin e së parës me të dytën. Pse e them këtë? Sepse, në qoftë se do të ishte që ne miratojmë një marrëveshje, në të cilën kontribuon edhe qeveria shqiptare, për të hapur një sportel që t'i çojmë shqiptarët në Gjermani, në parim unë do të isha kundër kësaj marrëveshjeje. Në qoftë se ky komponent është i parëndësishëm, dhe komponenti më i rëndësishëm është t'u japim shqiptarëve ofertën shqiptare, pra që kanë mundësi për të ngritur jetën e tyre këtu, një prej të cilave është arsimiti profesional, gjë për të cilën jam i bindur, atëherë sigurisht që do të kisha qëndrim tjetër në lidhje me këtë marrëveshje.

Kjo është arsyeja pse duam një sqarim më të detajuar në lidhje me këtë.

Ulsi Manja – Po.

Dajna Sorensen – Absolutisht, unë ndaj të njëjtin mendim me ju. Për sa i përket balancës, në këtë moment nuk i kam shifrat e sakta për të thënë se cilat aktivitete do të kenë peshë më të madhe. Megjithatë, duke parë outputet që parashikon ky projekt dhe përqendrimin e madh që ka projekti, dhe qëndrimin e tij pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, automatikisht fokusi i këtij programi është integrimi në tregun shqiptar të punës. Nuk është domosdoshmërisht informimi në lidhje me Gjermaninë.

Sportelet e emigracionit, në mënyrën si janë konceptuar në vendin tonë, janë të tilla, që japin informacion emigrantëve të kthyer. Këto janë sportele emigracioni ku ne, së bashku me Ministrinë e Mbrojtjes, informojmë sidomos emigrantët e kthyer, në momentin kur ata kthehen në Shqipëri.

Lloji i shërbimeve që ofrohet pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në sportelet e emigracionit, ka të bëjë ekskluzivisht me integrimin e këtyre personave në tregun e punës.

Megjithatë, që sot, deri në fund të ditës, ne mund t'ju kthejmë një përgjigje të detajuar për sa i përket fondeve, se ku do të shkojë një pjesë apo një tjetër. Në këtë moment nuk e kam këtë lloj informacioni.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Çuçi!

Faleminderit, kryetar!

Informacioni në lidhje me këtë çështje do të ishte më se i mirëpritur, sepse ndan edhe qëndrimin tim personal në lidhje me këtë projekt.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Faleminderit, zonja zëvendësministre, për sjelljen e kësaj marrëveshjeje! Në vijim të asaj që ngriti me shumë të drejtë kolegu Çuçi shoh objektivat, të paktën sipas relacionit, se ku do të fokusohet kjo marrëveshje. Tre objektivat e para lidhen me mundësinë e hyrjes në tregun gjerman të punës dhe trajnimet përkatëse për personelin e sporteleve të emigracionit. Unë jam e interesuar dhe kam një pyetje: cila është qasja në këtë projekt për emigrantët e kthyer? Të paktën, nga kronika që kam parë këto ditë në medie rezulton se ata po hasin vështirësi për integrimin e tyre në Shqipëri. A ka ndonjë gjë konkrete? Thjesht informim, përgatitje fletëpalosjesh apo është menduar edhe krijimi i mundësisë së punësimit të tyre?

Te përmbledhja shpjeguese e projektaktit shpreheni: “Bashkëpunimi me diasporën dhe ide biznesi për zhvillim”. Është fjala për ide biznesi në Shqipëri apo se si të integrojmë emigrantët tanë shqiptarë në tregun gjerman? Unë do të isha në favor dhe do ta theksoja me forcë se ne nuk duhet të inkurajojmë ikjen e shtetasve shqiptarë jashtë dhe mendoj se duhet të punojmë më mirë për të hapur vende pune dhe për t’i nxitur ata të punësohen menjësisht në Shqipëri, por sidomos kthimin e emigrantëve të orientuar nga zhvillimi i tyre, nuk e gjej shumë të trajtuar në këtë marrëveshje dhe do të doja pak më shumë informacion.

Ulsi Manja – Po, zonja

Dajna Sorensen- Faleminderit, zonja Hysi!

Unë do t’i kthehem përsëri funksionit primar të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, që është informimi dhe integrimi në tregun e punës. Janë pikërisht zyrat e punësimit ato të cilat disponojnë informacion për vendet e lira të punës për integrimin e këtyre personave në tregun e punës. Kjo ka qenë një kërkesë e projektit që në fazat e para, që zyrat e tyre të mos ndodheshin diku në Tiranë apo në qytete të tjera, por të jenë të integruara pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit për t’u ofruar emigrantëve të kthyer mundësi konkrete punësimi bazuar në *database* vendesh të lira pune, që ekzistojnë pranë SHKP-së. Prandaj edhe vendndodhja e këtij projekti është pranë këtyre zyrave.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm që ju e përmendët në pyetjen tuaj të dytë është edhe pjesa e vetëpunësimit, apo e ngritjes së bizneseve nga emigrantët e kthyer. Në bashkëpunim

me SHKP-në ne kemi hartuar një projektvendim të ri, që do të jetë një program i veçantë, i cili synon vetëpunësimin e atyre individëve, të cilët nuk e gjejnë domosdoshmërisht veten e tyre në vendet e punës ekzistuese. Ne jemi duke lancuar dhe konkretisht të premtën lancojmë një fazë pilotimi, pikërisht të këtij programi, ku përfitues do të jenë edhe emigrantët e kthyer. SHKP-ja ka një pjesë të programeve për nxitjen e punësimit, ka një program të dedikuar të veçantë që targeton emigrantët e kthyer, një grup vulnerabël, i cili përfiton nga subvencioni i pagave, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore me synimin e vetëm integrimin e këtyre individëve në tregun e punës.

Një tjetër element që do të doja të nënvizoja është se kemi informacion të detajuar se sa ka qenë numri i këtyre përfituesve sipas kategorive. Deri në fund të ditës unë mund t'jua vë në dispozicion.

Ulsi Manja - Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Shumë faleminderit, për informacionin!

Kam edhe një pyetje. Më tërhoqi sqarimi i fundit që bëtë, i cili përkon edhe me një nga objektivat se ku do të fokusohet kjo marrëveshje. A kemi një bazë të dhënash se sa emigrantë janë të kthyer sipas njësive vendore, sipas profileve dhe aftësive që ata kanë? A ka ndonjë bashkëpunim midis pushtetit qendror dhe atij vendor për integrimin e tyre?

Dajna Sorensen - Për këtë pyetje, për pjesën e fundit të pyetjes, nuk kam një përgjigje të drejtpërdrejtë për bashkëpunimin me institucionet e qeverisjes lokale.

Për sa i përket pjesës së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme, kemi informacion se sa është numri i personave të kthyer, nuk e kemi të përditësuar ashtu siç kemi informacionin e personave që raportojnë pranë zyrave të SHKP-së. Ne e dimë se vetëm një pjesë relativisht e vogël janë atë të cilët edhe në momentin që kthehen shkojnë pranë zyrave tona. Ky projekt këtë synon, që të japë ndër të tjera një informacion të detajuar se çfarë ofrojmë, ose për ta bërë atë paketë të shërbimeve që ekziston edhe më të dukshme, edhe më atraktive ndaj këtij target grupi të veçantë.

Do të shtoja edhe një element të fundit që është shumë i rëndësishëm që u përket jo vetëm emigrantëve të kthyer, në rastin konkret nga Gjermania apo nga vendet e tjera, por në përgjithësi të gjithë atyre qindra dhe mijëra shqiptarëve që kanë qenë në emigracion ndër vite. Në kuadrin e ligjit “Për arsimin dhe formimin profesional”, një element shumë i rëndësishëm që ne po shikojmë është njohja e aftësive profesionale që janë përfituar në mënyrë jo formale

dhe krijimi i mundësive që kur ata hyjnë në tregun shqiptar të kenë një njohje formale të atyre aftësive që mund t'i kenë kërkuar edhe në vendet e tjera në rrugë formale ose joinformale, për një vlerësim adekuat.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Nuk besoj se ka pyetje dhe diskutime të tjera nga kolegët. Përpara se të kalojmë në votim këtë marrëveshje, zonja Zëvendësministre do t'ju lutesha që përpara se të përmbyllim raportin për komisionin përgjegjës, të na vini në dispozicion informacionin që kërkoi kolegu Çuçi, por edhe zonja Hysi, me qëllim që edhe raporti ynë për komisionin përgjegjës të jetë më i plotë, duke evidentuar edhe problematikat që ngritën kolegët, të cilat janë shumë të rëndësishme të themi të drejtën, që të mos të na ndodhë që ne t'i mëshojmë fort arsimit profesional, për të përgatitur fuqi punëtore për në Gjermani apo për në vendet e tjera të BE-së.

Hedhim në votim në parim këtë projektligj.

Kush është pro në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? 1 abstenim nga zoti Çuçi, për të cilin jam i bindur se do t'i bashkohet votës pro në seancë, pasi të vijë informacioni i kërkuar.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj?

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Ky projektligj së bashku me raportin, që do të hartojë kolegu Leka, do t’i përcillet komisionit përgjegjës e më pas, seancës plenare për votim. Me miratimin e kësaj projektmarrëveshjeje, e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Mbledhja e radhës...

Bashkim Fino – Një sekondë, se kam një sugjerim!

Ulsi Manja – Urdhëroni!

Bashkim Fino – Mbledhja mbaroi. Ne sot miratuam 3,5 milionë euro grant. Kaq bëmë ne sot. 2 milionë i kaluam me projektligjin e parë dhe 1,5 milionë euro i kaluam me projektligjin e dytë. Pra, ngritëm dorën të gjithë ne për 3,5 milionë euro grant, pavarësisht se kishim vërejtje e të tjera e të tjera.

Po i them edhe një herë zëvendësministres që ta marrë dhe ta shikojë së bashku me Ministrinë e Financave. Mos na i sillni grantet për miratim në parlament! Nuk ka ligj për grantet. Ka vetëm për kreditë.

Ulsi Manja – Kjo nuk është çështje që e zgjidh zëvendësministrja këtu, zoti Fino. E ke ngritur për 2 vjet rresht këtë çështje.

Bashkim Fino – Kjo është një çështje shumë ofenduese.

Ulsi Manja – Përderisa nuk ka gjetur zgjidhje në rrugë parlamentare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Pse bërtet? Unë kam të drejtë ta bëj këtë debat me ju, meqë mbledhja ka mbaruar.

Ulsi Manja – Nuk e kam mbyllur akoma mbledhjen.

Mbledhja e sotme e komisionit mbyllet këtu. Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t’ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA